STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për njoftim të menjëhershëm: 4 nëntor 2012

GUVERNATORI CUOMO SIGURON DONACIONIN E PARË TË MADH PRIVAT PËR TË MBËSHTETUR NJUJORKEZËT NË PËRPJEKJEN PËR RIMËKËMBJE

PepsiCo dhe Walmart dhurojnë një total prej 14 kamionë të mbushur me ushqime, pije, lëndë pastruese dhe lojëra për fëmijët

Guvernatori Andrew M. Cuomo njoftoi sot se shteti i Nju Jorkut ka siguruar donacionin e parë të madh privat nga PepsiCo dhe Walmart për të mbështetur njujorkezët në përpjekjet e tyre për rimëkëmbje pas uraganit Sandy.

"Qeveria e shtetit po përdor çdo burim në dispozicion për të ndihmuar për rimëkëmbjen nga dëmtimet dhe humbjet të shkaktuara nga uragani Sandy", tha guvernatori Cuomo. "Por gjithmonë ka nevojë për më shumë prandaj donacionet private si këto nga Walmart dhe PepsiCo sigurojnë një ndihmë jetësore për familjet tona jeta e të cilave është ndikuar nga stuhia. Unë falënderoj PepsiCo dhe Walmart për bujarinë e tyre".

"Familja e PepsiCo e di se shumë nga qytetarët tanë kanë nevojë urgjente për ndihmë dhe se ne jemi të gatshëm të japim kontributin tonë, tha kryetari dhe drejtori ekzekutiv i PepsiCo, Indra Nooyi. "Ne përgëzojmë guvernatorin Cuomo për drejtimin e tij dhe dhurojmë sasi të konsiderueshme të produkteve tona ushqimore dhe pijeve për të ndihmuar sa më shumë nga komunitetet e prekura".

"Uragani Sandy shkaktoi shkatërrime të papara për miliona njerëz", tha Gisel Ruiz, shefi i operacioneve të Walmart U.S. "Momente si ky kërkojnë që ne të gjithë të bashkohemi – biznese, qeveri dhe komunitet - për të ndihmuar fqinjët tanë të rindërtojnë jetën e tyre. Walmart angazhohet të japë kontributin e vet në përpjekjet për rimëkëmbjen dhe do të vazhdojë të koordinojë nga afër punën me drejtues si guvernatori Cuomo për të ndihmuar plotësimin e nevojave për ata në nevojë në këto momente të vështira".

Walmart dhuroi gjashtë kamionë me ngarkesa me 60 palete me ushqime të thata dhe pije freskuese, 5.895 arka me lëndë pastruese dhe 2.051 lojëra. PepsiCo dhuroi pesë kamionë të mbushur me pije freskuese dhe tre kamionë të ngarkuar me ushqime të thata, një total prej më tepër se 100,000 arka me produkte. Përveç kësaj, PepsiCo është angazhuar për të dhuruar edhe 22 kamionë të tjerë të mbushur me artikuj të ngjashëm në javën që vjen.

Këto donacione u ngarkuar në automjetet e Gardës Kombëtare dhe do tu shpërndahen njujorkezëve në nevojë në të gjitha zonat e dëmtuara. Guvernatori ishte në qendrën Javits në Manhattan sot pasdite për të ndihmuar në ngarkimin e donacioneve.

Albanian

Po sot, guvernatori caktoi sekretarin e shtetit Cesar Perales si koordinatorin e shtetit për kontributet e korporatave. Në këtë pozicion, Z. Perales do të mbikëqyrë dhe ndërmjetësojë kërkesat e tjera nga organizatat private që duan të dhurojnë ndihmë për njujorkezët. Organizatat e interesuara në dhënien e donacioneve mund të shkojnë në sitin e guvernatorit në http:/www.governor.ny.gov/sandycompanydonations.

PepsiCo dhuroi tetë kamionë të ngarkuar me artikujt e mëposhtëm:

ARTIKUJ DHURUAR NGA PEPSICO
Pije freskuese
Aquafina
Lipton Tea
Pepsi
Diet Pepsi
Gatorade
Propel
PepsiNext
Mountain Deë
Diet Mountain Deë
Ushqime të lehta
Lays
Doritos
Lays Stax
Quaker Cheëy and Breakfast Bars

Walmart dhuroi 6 kamionë të ngarkuar me artikujt e mëposhtëm:

ARTIKUJ DHURUAR NGA WALMART	SASIA
Ushqime të thata	
Cereal	21 palete
Kuti me lëng frutash	17 palete
Ushqime të lehta	22 palete
Total	**60 palete**
Lëndë pastruese	
Sfungjer abraziv i fortë (3-pjesë)	496 arka
Great Value Pako çift me letër pastruese dezinfektuese	803 arka

Albanian

Great Value Pako dezinfektuese me 35 fletë	146 arka
Great Value Pako dezinfektuese me 35 fletë me aromë	200 arka
Germ-X Aloe 10oz	611 arka
Germ-X 10oz	235 arka
Lëng pastrues enësh Ajax Lemon 52oz	120 arka
Lëng pastrues enësh Ajax Grape Fruit 52oz	60 arka
Batanije Grey T/TXL	24 arka
Great Value Top letre pastruese	2240 arka
Great Value Zbardhues Regular Bleach 182oz	960 arka
Total	**5895 arka**
Lojëra (kartoni)	
Loja Candyland	1100 copë
Loja Memory Assortment	548 copë
Chutes and Ladders	403 copë
Total	**2051 copë**

###

Lajme të tjera do t'i gjeni në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418

Albanian